



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKTLIGJ

Nr. _____/2025

PËR

DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.80/2021,
“PËR REGJISTRIMIN E ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr.80/2021, “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

Neni 1

Kudo në përmbajtjen e ligjit:

- a) emërtimi “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë” zëvendësohet me “Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”, sipas kuptimit të fjalisë;
- b) fjala “fillestar” zëvendësohet me fjalët “për herë të parë”.

Neni 2

Në nenin 3, pikat 10 dhe 11, në nenin 6, pika 1, në nenin 10, në nenin 11, pika 1, titullin e seksionit IV, në nenin 33, pika 2, si dhe në nenin 35, pika 1, fjalët “regjistrim tjetër” zëvendësohen me “regjistrim i ndryshimeve të të dhënave”, sipas kuptimit të fjalisë.

Neni 3

Neni 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj përcakton procedurat e regjistrimit të organizatave jofitimprurëse, sipas legjislacionit në fuqi, që përcakton rregullat për themelimin, regjistrimin, funksionimin, organizimin dhe veprimtarinë e organizatave jofitimprurëse, si dhe rregullat për mbajtjen e regjistrit të tyre.”.

Neni 4

Pika 9, e nenit 3, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9. “Regjistrimi për herë të parë” është regjistrimi i organizatave jofitimprurëse pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me qëllim fitimin e personalitetit juridik.”.

Neni 5

Titulli i seksionit II, të kreut II, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Regjistrimi i organizatave jofitimprurëse, rregullat e emërimit, personat e autorizuar dhe forma e akteve shoqëruese”.

Neni 6

Neni 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 8
Regjistrimi i organizatës jofitimprurëse

Kërkesa për regjistrimin për herë të parë, si dhe kërkesa për regjistrimin e ndryshimeve të të dhënave paraqitet në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, sipas legjislacionit në fuqi për organizatat jofitimprurëse.”.

Neni 7

Titulli i nenit 17 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Regjistrimi i ndryshimeve të të dhënave”.

Neni 8

Neni 25 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 25
Vendimmarrja e gjyqtarit

Vendimi për regjistrimin për herë të parë të organizatave jofitimprurëse ose për regjistrimin e ndryshimeve të të dhënave, si dhe vendimi për çregjistrimin e tyre merret nga një gjyqtar i seksionit tregtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë ligj.”.

Neni 9

Neni 26 shfuqizohet.

Neni 10

Titulli i nenit 30 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Përfashtimi i gjyqtarit”.

Neni 11

Pika 5, e nenit 33, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Kundër vendimit të gjyqtarit për mospranimin e kërkesës për regjistrimin për herë të parë të organizatave jofitimprurëse ose kërkesës për ndryshimin e të dhënave mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve punë nga njoftimi i vendimit.”.

Neni 12

Neni 34 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 34
Përmbajtja e vendimit të regjistrimit

Vendimi i gjyqtarit për regjistrimin për herë të parë të organizatave jofitimprurëse ose për regjistrimin e ndryshimeve të të dhënave duhet të përmbajë në mënyrë të plotë çështjet, që duhet të pasqyrohen në regjistrin elektronik.”.

Neni 13

Në pikën 1, të nenit 39, fjalët “..., brenda afatit të përcaktuar në këtë ligj për regjistrimin fillestar, ...” hiqen.

Neni 14

Pas pikës 1, të nenit 49, shtohen pikat 1/1, 1/2 dhe 1/3, me këtë përmbajtje:

“1/1. Deklarimi në regjistrin elektronik i të dhënave të pavërteta, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, në masën 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë.

1/2. Moskryerja e detyrimit për regjistrimin e ndryshimeve të të dhënave përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, në masën 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë.

1/3. Vendimi i gjyqtarit për dënimin me gjobë ankimohet drejtpërdrejt në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.”.

Neni 15

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

ELISA SPIROPALI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. _____, datë _____

PËR

**PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR DISA NDRYSHIME
DHE SHTESA NË LIGJIN NR.80/2021, “PËR REGJISTRIMIN
E ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE”, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 81, pika 1, dhe 100, të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Propozimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.80/2021, “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”, të ndryshuar”, për shqyrtim e miratim në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, sipas tekstit dhe relacionit që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

BELINDA BALLUKU

MINISTRI I DREJTËSISË

ULSI MANJA